



Përgjigje: Ndryshime në ndihmën shoqërore nga muaji janar 2025

Drejtuar palës së interesuar:

Një ligj i ri mbi ndihmën shoqërore, Ligji mbi Ndhimat Shoqërore dhe Luftën kundër varfërisë (LASLP), do të hyjë në fuqi në muajin janar 2025. Do të ketë disa ndryshime në marrëdhënien tuaj me Hospice général, të cilat do të sjellin përfitim për të gjithë.

Objektivi kryesor i këtij ligji është forcimi i mbështetjes së ofruar përfituesve të ndihmës shoqërore për të lehtësuar integrimin e tyre shoqëror dhe profesional. Ai synon gjithashtu të përballojë sfidat e varfërisë në Gjenevë dhe të lehtësojë qasjen në ndihmën shoqërore.

Për këtë arsye, përfitimet tuaja financiare do të rriten dhe do të plotësohen me shuma fikse. Këto shuma fikse do t'ju mundësojnë t'i menaxhoni disa nga faturat vetë, të cilat më parë i dërgonit tek Hospice général. Në këtë mënyrë do të jeni më të pavarur në menaxhimin e buxhetit tuaj.

Për t'ju mbështetur në fillimin ose rikthimin tuaj në punë, qoftë edhe me kohë të pjeshme, do të aplikohet një shumë që do të zbritet nga të ardhurat sapo të filloni të fitoni. Për këtë arsye, të ardhurat tona mujore do të rriten kur punoni.

Në ligjin e ri janë shtuar edhe ndryshime të tjera. **Për më shumë informacion**, ju ftojmë:

- Të ndiqni dhe të lexoni videot shpjeguese dhe dokumentet në lidhjen e mëposhtme: laslp.hospicegeneral.ch
- Takoni një anëtar të stafit të Hospice général përpara fundit të vitit, për të diskutuar me të rreth situatës suaj të veçantë

Sinqerisht,

Ekipi menaxhues i Hospice général